

## THE IMPACT OF LOUSSANE CONFERENCE IN ALBANIAN-TURKISH RELATIONS NDIKIMI I KONFERENCËS SË LOZANËS NË MARRËDHËNIET SHQIPTARO-TURKE

ANDUANA SHAHINI (KERTALLI)  
kanduana@yahoo.it

AKTET VI, 3: 202 - 205, 2013

### PERMBLEDHJE

Punimi përmban një historik të ndikimit të marrëdhënieve ndërshtetërore dhe impaktit që krijoi traktati i Lozanës mes Shqipërisë, Turqisë dhe Greqisë. Qëllimi është të evidentojë ndikimin e vendimeve të traktatit të Lozanës në lidhje me popullsinë. Përfshirja e popullsisë çame si populli i shkëmbyeshme mes Greqisë dhe Turqisë shkaktoi acarimin e palës shqiptare dhe në të njëjtën kohë fillimin e përpjekjeve për të rregulluar situatën në favorin e saj nëpërmjet palës Turke. Ky traktat përfaqëson kalvarin e vuajtjeve të popullit çam. Burimi kryesor i materialeve është Arkivi Qendror i Shtetit, si dhe gazetat e viteve 1920-1930. Në dokumentet dhe burimet arkivore hidhet dritë mbi disa aspekte të ndikimit të faktorit grek përmes traktatit të Lozanës, në acarimin e marrëdhënieve shqiptaro-turke. Qeveria turke me gjithë presionin nga qeveria shqiptare mbi këtë çështje mbajti dy qëndrime, por në të dy rastet jo në favor për palën shqiptare.

**Fjalët çelës:** Traktati i Lozanës, Çamëri, komisioni mikst.

### SUMMARY

The paper contains a historic of inter-state relations and the impact that created the treaty of Lausanne between Albania, Turkey and Greece. The aim is to highlight the impact of the decisions of the Lausanne Treaty in relation to the population. Involvement of the Cham population as exchangeable population, between Greece and Turkey caused irritation to the Albanian government and at the same time the beginning of efforts to remedy the situation in its favor by the Turkish side. This treaty represents the suffering Calvary of the Cham population. Main source is the Central State Archive materials, and newspapers of the years 1920-1930. In the documents and archival sources emerge some aspects of the impact of Greek factor through the Treaty of Lausanne, the exacerbation of the Turkish-Albanian relations. Turkish government despite pressure from the Albanian government on this issue held two positions, but in both cases not entirely favorable for the Albanian part.

**Key words:** Treaty of Lausanne, Cham population, mixed commission

### Hyrje

Konferenca e Lozanës njihet nga studiuesit dhe opinionin publik si një marrëveshje greko-turke mbi shkëmbimin e popullsisë. Rajoni i Ballkanit mbart disa çështje tipike si: minoritetet, kufijtë dhe nacionalizmi, të cilat gjatë historisë së tij, shpesh kanë prodhuar konflikte ose marrëveshje dy palëshe sipas rastit. Si pasojë e zgjidhjeve të diktuar nga Konferenca e Paqes së Parisit, pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Ballkani pësoi një ndryshim rrënjësor territorial duke sjellë edhe një vatër të re konflikti me qendër

popullsitë e lokalizuara në pjesët territoriale të shteteve, territoret e të cilëve u rruhdhën. Rasti tipik është Shqipëria. Në këtë studim do të ndalem në pasojat që solli Konferenca e Lozanës në marrëdhëniet turko-shqiptare. Në kuadrin e marrëdhënieve shqiptaro-turke, një pozicion të veçantë, në vitet 1923-1925, ka edhe Greqia, sepse ajo ishte pjesë e marrëveshjes me Turqinë në Traktatin e Lozanës. Kjo periudhë përkon me fillimin e tratativave të Greqisë e Turqisë për të përmbyllur një marrëveshje për shkëmbimin e popullsisë midis dy vendeve. Shqipëria ishte e

përfshirë tërthorazi në këtë ngjarje, sepse marrëveshja përfshinte myslimanët e Çamërisë.

### Zhvillim

Fqinji ynë jugor, në tërësi, është përpjekur të realizojë një tezë të vetën në lidhje me Shqipërinë. Politika e saj ndaj Shqipërisë nuk ishte miqësore, sidomos pas shpalljes së Pavarësisë, synimet e saj vazhduan edhe pse Shqipëria ishte shkëputur nga Perandoria Osmane. Greqia dhe politika e saj në vitet 1920 gjithmonë ka dashur: *“Shqipërinë e Jugut, dobësimin e shtetit shqiptar, të zbuste ndikimin Italian në Shqipëri, të vërtetonte që Shqipëria është e pa aftë të vetëqeveriset, dhe që ishte një shtet i padenjë për një fqinj të aqytetëruar si Greqia.”* (Swire.J 2005).

Edhe pas vitit 1912 qëndrimi i qeverisë greke është i dyzuar sepse

“megjithëse Greqia e njohu zyrtarisht pavarësinë e Shqipërisë në muajin qershor, ajo e bëri këtë me një rezervë në lidhje me kufijtë, nuk emëroi përfaqësues diplomatik deri në fund të vitit dhe vazhdoi të shkaktonte shqetësime kudo ku paraqitej mundësia.” (Swire 2005).

Kështu Greqisë i interesonte që çamët si dhe popullsi të veçanta të Maqedonisë t'i quante myslimanë e t'i këmbente me popullsi të trevave të caktuara të Turqisë që ajo i quante grekë të krishterë. Pikërisht ky problem u diskutua në Konferencën e Lozanës. Atje morën pjesë përfaqësues grekë dhe turq, ndërsa pala shqiptare ishte thjeshtë për të bërë objeksionet e saj në mënyrë që pasojat të ishin sa më të vogla të ishte e mundur. *“Kur filloi të bisedohej marrëveshja, fillimisht nuk u përmendën myslimanët shqiptarë, por qeveria greke vendoste për ta si kriter vetëm një provim gjuhe.”* (“Shqipëri e re” 1925) Ky lajm u përcoll menjëherë nga shtypi i kohës, i cili nuk i fshehu aspak rezervat e tij. Gazeta “Shqipëri e re” në kryeartikullin e saj shprehet *“Qeveria greke në marrëveshje me qeverinë turke ka vendosur shkëmbimin e 5000 çamëve, të cilët do të dërgohen në Turqi dhe në vend të tyre do të instalohen 5000 grekë të ardhur nga Turqia.”* (“Shqipëri e re” 1925) Qeveria shqiptare nuk e

fshehu frikën e saj për rrjedhën që do të merrnin ngjarjet në të ardhmen, pasi vetë ajo këmbënguli në Lidhjen e Kombeve që të mbahej qëndrim ndaj veprimeve të dy vendeve Greqisë e Turqisë dhe nga ana tjetër vazhdonte tratativat me Turqinë për nënshkrimin e një traktati dypalësh. Në fakt, pjesë e këtij traktati të nënshkruar në 1923 (Traktati i miqësisë) u bënë edhe çështjet e pronësisë dhe nacionalitetit. Problemi i popullsisë nuk do të kalonte pa kundërshtime, ndaj u vendos në Lidhjen e Kombeve që të përcaktohej një komision i posaçëm që të trajtonte mënyrën se si do të këmbehej popullsia. Pra të vendoseshin kriteret mbi bazën e të cilave do të trajtohej popullsia e shkëmbyeshme. Lajmi se *“Qeveria greke emëroi në nëntor të 1923-it komisione të posaçme, të cilave u kërkoi të përfshinë në radhët e të këmbyerve edhe myslimanë.”* (Gazeta “Shqipëri e re” Tiranë 1925) shkaktoi një polemikë të madhe në Shqipëri dhe jehona shkoi deri në Lidhjen e Kombeve, ku patriotët tanë e mbrojtën çështjen e popullsisë çame. Dukej që sjellja e Greqisë ndaj shqiptarëve do të ishte një faktor vendimtar për relacionet që Shqipëria do të lidhte me Turqinë, për të mbrojtur popullsinë e saj. Edhe vetë Noli shkoi në Gjenevë për të mbrojtur çështjen çame. Diskutimin e tij në emër të qeverisë shqiptare ai e mbajti më 10 shtator 1924. Noli pati rastin dhe mbrojtiti me forcë çështjen çame, duke u ngritur kundër shkëmbimit të popullsisë së Çamërisë prej qeverisë greke sipas traktatit greko-turk të Lozanës (Duka.V 2007). Gjithashtu, edhe një figurë tjetër e njohur, Pandeli Evangjeli, i drejtohet Mehmet Konicës me një letër ku i kërkon ndërhyrjen e tij në *“ndërhyrjen e delegacionit britanike në Lozanë që shqiptarët të mos marrin pjesë në borxhin e Turqisë...”* (AQSH.1923) Këtu Z. Pandeli Evangjeli i referohet faktit që Shqipëria nuk duhet të trajtohet si pjesë e Turqisë dhe rrjedhimisht e borxhit të saj në raport me vendet e tjera. Por, kjo i duket e pa mundur Konicës, pasi nuk ka kohë ta takojë përfaqësuesin britanik, i cili ndodhet vetë atje dhe e dyta, i duket e pa mundur një realizim i tillë dhe lutet që vendimi të jetë sa më i lehtë të jetë e mundur. Për çështjen e popullsisë dhe problemit

që shkaktonte ajo, pikërisht për këtë qëllim u ngrit dhe një komision i posaçëm me pjesëmarrjen e një përfaqësuesi grek, një shqiptari dhe një turku duke u quajtur "komisioni Mikst". Detyra themelore e tij ishte të evidentonte origjinën e popullsisë që duhej këmbyer, duke përcaktuar edhe nacionalitetin e tyre. Komisioni vendoste se cili do të ishte fati i popullsisë ortodokse çame. Fatin e popullsisë ortodokse shqiptare në Turqi pas traktatit greko-turk, e përcaktoi komisioni Mikst. Ky komisionin dha vendimin definitiv se "ortodoksët e vendosur në Turqi konsiderohen përgjithësisht Rum dhe veç atyre që janë çam deri më tash, deri në 1918, ECHABLES." (AQSH.1923). Ky vendim u mor pa pasur parasysh mospëlqimin e Z. Goreani, përfaqësuesin italian të Lidhjes së Kombeve, duke shkaktuar edhe një indinjatë dhe reagim të ashpër të shqiptarëve. Qeveria shqiptare i dërgoi një notë komisionit Mikst, në lidhje me këtë padrejtësi të madhe që po i bëhej popullsisë shqiptare. Meqenëse me qeverinë greke ishte tepër e vështirë komunikimi mbi këtë pikë, qeveria shqiptare iu drejtua Z. Hans Hotstad për t'i dhënë një përgjigje. Në lidhje me problemin ai përsëri iu drejtua qeverisë shqiptare se "gjithçka mbetet në kompetencë të komisionit dhe të traktatit të përbashkët mes Turqisë dhe Greqisë." (AQSH. 1923). Me gjithë punën e komisionit, u vu re që problemi nuk ishte aq i thjeshtë. Të dy kriteret e vendosura ishin utopikë për t'u realizuar në të vërtetë, sepse popullsia ndodhej nën presion. Qeveria greke nga ana e saj ishte përpjekur maksimalisht që të aprovohej gjithçka në favorin e saj. Në këto kushte "komisioni Mikst e trajtoi me vëmendje situatën dhe në 1924 vendosi që duhej një komision më i posaçëm për të trajtuar më mirë çështjen." ("Shqipëri e re" 1923) Amplituda e qëndrimit të qeverisë turke mbi ortodoksët shqiptarë ka evoluar dhe ka marrë faza të ndryshme. Sipas dokumentacionit në AQSH, sjellja e qeverisë turke ka evoluar si më poshtë:

Faza e parë "fillon, atëherë kur Turqia kërkonte që të triumfonte teza e saj mbi pikën e traktatit "të këmbyeshem", delegati turk kërkonte që Shqipëria të mos ngulë këmbë për

ortodoksët dhe kërkonte heshtjen tonë si këmbim për mos pranimin e çamëve në Anadoll. (AQSH.1924)

Faza e dytë përkon me situatën kur "interpretimi i fjalës "të këmbyeshem" mori një formë të re, kështu që afro 140000 grekër të vendosur në Stamboll para 1918 do qëndrojnë në Stamboll; bashkë me ta do të qënrojnë edhe shqiptarët ortodokse." (AQSH.1924) Problemi qëndron në faktin se asnjëherë qeveria greke nuk e pranoi që duhej të futej ajo vetë në bisedime me qeverinë shqiptare për ta zgjidhur çështjen, sepse në fund të fundit bëhej fjalë për popullsi çame me origjinë shqiptare. Duke ia deleguar për zgjidhje problemin dërgatës së Lidhjes së Kombeve pra, komisionit Mikst, Greqia e mënjanonte fare Shqipërinë nga problemi, duke mos i dhënë as edhe një të drejtë për të mbrojtur popullsinë e saj. Ky është një nga faktet më të shëmtuara të dëbimit të popullsisë me pa të drejtë nga trojet e tyre. Problemi i këmbimit të popullsisë mes dy vendeve jo vetëm që ishte i pa drejtë, por solli edhe mjaft pasoja të cilat nuk u zgjidhën as në vitet në vazhdim. Problematika e tyre shfaqet që në pajisjen me pasaportë, leje qëndrimi, çështje të punësimit e mbi të gjitha të pasurive të tyre. Interesimi i Fuqive të Mëdha në Konferencën e Lozanë ka qenë gjithmonë i pranishëm, sidomos në përmbajtjen e kriterëve të vendosura dhe zbatimin korrekt të tyre. Mbi këtë fakt shtypi i kohës boton artikuj të ndryshëm. Në gazetën "Shqiptari i Amerikës" pohon, në rubrikën lajme nga jashtë, se në Konferencën e Lozanës Lord Gurzoni ka thënë: "Kërkoj zotime të plota nga Turqia për mbrojtjen e minoriteteve, dhe proponoj për një komision ndërkombëtar më qendër në Stamboll nën kontrollin e Lidhjes së Kombeve, i cili të kujdeset për të drejtat e minoriteteve." ("Shqiptari i Amerikës" 1923) Duket që Lidhja e Kombeve i kuptonte shqetësimet e Shqipërisë dhe e kuptonte synimin e Greqisë. Në fakt realiteti tregoi krejt ndryshe. Me gjithë ndërhyrjet e vazhdueshme të qeverisë shqiptare pranë autoriteteve turke, traktati do të zbatohet sipas interpretimit të kriterëve që do t'i bënin të dy shtetet sidomos Greqia.

## Konkluzione

Traktati i Lozanës gjithmonë është përdorur si një faktor imponues në marrëdhëniet e Shqipërisë me Turqinë, por duke qenë se bëhej fjalë për popullsi të trevave shqiptare, presioni që do të bënte kjo e fundit ndaj qeverisë turke ishte i pritshëm, pavarësisht rezultatit. Ndërhyrjet më të mëdha janë drejtuar ndaj qeverisë turke për arsye se me këtë të fundit shteti shqiptar sapo kishte nënshkruar edhe një traktat miqësie. Sipas këtij traktati, përveç sigurimit të marrëdhënieve diplomatike ishte parashikuar edhe rregullimi i marrëdhënieve shoqërore. Në pikat tre dhe pesë të traktatit të miqësisë parashikohej rregullimi i çështjes së nacionalitetit dhe i pasurisë mes shtetasve shqiptarë dhe turq në të dy vendet. Në këtë kuadër qeveria shqiptare e shtoi presionin e saj ndaj qeverisë turke duke i kërkuar zbatimin e traktatit dhe respektimin e minoriteteve pasi në këtë traktat të dy palët ishin të barabarta. Qeveria turke, e ndodhur nën një presion të dyfishtë, Shqipëria që kërkonte të mos zbatohet ky traktat ose minimalisht të zbatohet drejt në përputhje më të gjitha klauzolat edhe Greqia nga ana tjetër që kërkonte të zbatonte traktatin në favorin e saj dhe disfavorin e popullsisë çame, vendosi të mbajë një qëndrim të dyfishtë. Fillimisht ajo qëndroi indiferente ndaj kësaj çështje dhe më pas kërkoi të zbatohet drejt ky traktat. Traktati i Lozanës ndikoi në rrjedhën e marrëdhënieve mes Shqipërisë dhe Turqisë sepse shkaktoi disa tensione mes palëve. Qeveria shqiptare, duke qenë së nuk mund të gjente rrugë bashkëpunimi me qeverinë greke, iu kthye bisedimeve me palën turke. Ky presion u bë në kohën kur edhe pozicioni i Shqipërisë sapo ishte

afirmuar në diplomacinë turke. Pikërisht për këtë arsye pozicioni i Turqisë ka qenë fillimisht pro këtij shkëmbimi në favor të palës greke duke shkaktuar një indinjatë të madhe në qarqet diplomatike shqiptare dhe diasporë. Me shtimin e bisedimeve, lutjeve e apeleve të dërguara në Turqi, kjo e fundit e ndryshoi disi kursin e saj politik duke vendosur si kusht përcaktimin e zbatimit e kriterëve për popullsinë e shkëmbyeshme.

## Bibliografi

### Burime Arkivore

1. Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme
2. AQSh.

### Literaturë

1. Akademia e shkencave (2007) *“Histori e Shqipërisë”* vëll. III. Tiranë, Toena ;
2. Duka, Valentina, (2007) *Histori e Shqipërisë 1912 – 2000*, Tiranë, Kristalina – KH;
3. Fischer, J. Bernd, (2004) *Mbreti Zog dhe përjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë, Çabej;
4. Puto, Arben, (2009) *Shqipëria politike 1912 – 1939*, Tiranë, Toena;
5. Swire, Joseph, (2000) *Shqipëria ngritja e një mbretërie*, Tiranë, Dituria;

### Periodikë të viteve 1920 – 1930

1. “E Drejta”
2. “Shqipëri e re”
3. “Shqiptari i Amerikës”
4. “Paqja”
5. “Gazeta Shqiptare”.